



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1991/ 4 prot.

Datë 19.09.2023

**V E N D I M**

**Nr. 921/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.09.2023 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-77043-08-08-2023 me objekt “Kancelari dhe Tонера fotokopje dhe printerash”, me fond limit 1,333,333.33 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 21-08-2023, nga autoriteti kontraktor Bashkia Bulqize
- Ankimues:** “Interlogistic” SHPK me NIPT K21605003M dhe Adrese:  
*Autostrada Tirane-Durrës, Rruga Dytësore Km 9,  
Godinë 3 katëshe, Kashar, Tiranë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Bulqize  
*Lagjja “Minatori”*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit

*Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10-08-2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-77043-08-08-2023 me objekt “Kancelari dhe Tонера fotokopje dhe printerash”, me fond limit 1,333,333.33 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 21-08-2023, nga autoriteti kontraktor Bashkia Bulqize.

II.2. Në datën 14.08.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3355 dhe me nr. 1991/2023 prot., datë 14.08.2023 e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr. 1356/2 prot., datë 29.06.2023, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor mbi detyrimin e këtij të fundit për dhënie informacioni KPP-së lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK.

II.5 Në datën 12.09.2023 Komisioni Prokurimit publik dërgon shkresë me nr. prot 1991/2 Autoriteti Kontraktor, me lëndë “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK.

II.6. Nëpërmjet shkresës me nr. 4568/1 prot., datë 14.09.2023, protokolluar me tonën me nr. 1991/3 prot., datë 18.09.2023 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit ku citon, se “Njoftimi i anulimit të procedurës së prokurimit me nr REF -77043-08-08-2023 me objekt "Kancelari dhe Tонера Fotokopje dhe Printerash" me fond limit 1 333 333. 33leke pa tush ,Zhvilluar me date 21.08.2023, u publikua ne Buletinin e Prokurimeve Publike numer 73 date 28.08.2023.

Per sa kerkoni ne tuajen per ankesen e bere nga operatori ekonomik "Interlogistic" SHPK., prane Autoritetit Kontraktor Bashkia Bulqize nuk eshte paraqitur anje ankesa nga operatori ekonomik "Interlogistic" SHPK, për modifikim të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit me nr. REF -77043-08-08-2023 me objekt "Kancelari dhe Tонера Fotokopje dhe Printerash" me fond limit 1 333 333. 33 leke pa TVSh parashikuar për t'u zhvilluar ne date 21.08.2023.

II.7. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit nuk ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK.

II.8 Nga shqyrtimi i materialeve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomik në përputhje me nenin 113 të LPP-së, pranë Komisionit të Prokurimit Publik .

### III

## Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK ne ankesen e sipërpërmendur, për modifikimin e specifikimeve teknike të përcaktuar DST të procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi, operatori ekonomik shprehet, se *“Keto specifikime ne lidhje me artikujt e lartpërmendur nuk e justifikojne qëllimin per te cilin jane vendosur, pasi specifikime teknike te tilla nuk garantojne cilësinë ose standardin e larte per këto produkte. Ndër te tjera konstatojme se specifikimet teknike te artikujve te sipërpërmendur, te percaktuara nga ana AK jane kufizuese, diskriminuese dhe nuk garantojne te drejten e operatoreve ekonomike te interesuar për te marre pjesë ne kete procedure prokurimi. Theksojme se per te shmangur nje shtate te tille e cila te ben te mendosh se AK mund te adresojne ne nje marke te caktuar apo po kufizon konkurrencën, duhet te parashikoni specifikime për artikujt e mësipërm me nje rang me te madh te parametrave duke percaktuar nje marzh me te gjere specifikimesh e cila krijon mundesine e ofertimit te artikujve te ndryshem por gjithmone cilësore nga operatore ekonomike te interesuar per te marrë pjesë në kete procedure prokurimi.[..]. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 5 dhe 6 autoriteti kontraktor ka parashikuar specifikimet teknike për artikujt ;

### Shtojca 5.

*[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]*

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

*Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.*

*SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik*

*Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".*





*Skicimet, parametrat teknike etj:*

*Specifikimi I Materialeve:*

*Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:*

#### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

- **Bojë printeri RICO MP C3003:**Bojë prin multifunksional me ngjyrat 7225 kater bojrat.

006R01461 Black		22000 Kopje
006R01464 Cyan		15000 Kopje
006R01462 Yellow		15000 Kopje
006R01463 Magenta		15000 Kopje
- **Blloqe flete dalje:** Blloqe flete dalje 3 kopje ngjyra të ndryshme.
- **Bllok me ngjitje stick notes, 3 X 67 fletë, letër, e verdhë, portokalli, rozë** Numri i fletëve: 67 flete Ngjyra: Roze, portokalli Materiali: letër
- **Blloqe urdher dorëzimi:** Blloqe urdhër dorëzimi 3 kopje ngjyra të ndryshme.
- **Blloqet shënimesh** të jetë me rubrika të ndara, me 3 kopje ngjyra të ndryshme të jetë me ngjitje, me kapak të fortë kartoni, A5
- **Boje vule sasia 30 ml ngjyre blu**
- **Bojëra esenciale**

- **Bojëra uji**
- **Bojëra vaji**
- **Dosje me llastik 8 cm** Te jene me shkelqim ne sipërfaqe materiali te jete karton i trashë e veshur me material plastic, perdorshme per format A4, Materiali te jete i pademtuar . Dosjet duhet te kene permasat 35cm\*25c.
- **Dosje me mekanizem me kuti :** Dosje plastike me mekanizem gjerësia e dosjes 7 cm ngjyra te ndryshme me mekanizem shume I forte dhe cilesi e larte e materialit plastic dosja duhet të jetë e paisur me kuti Përmasa 32cm x 29cm x 7cm
- **Dosje personeli me logon e bashkise.**
- **Dosje me llastik me ngjyra:** Te jene me shkelqim ne sipërfaqe materiali te jete karton i trashë e veshur me material plastic, perdorshme per format A4, Materiali te jete i pademtuar . Dosjet duhet te kene permasat 35cm\*25c
- **Dosje te thjeshta kartoni**
- **DVD+RË 4X 4.7GB, CD-R 52X700MB ,DCD dhe CD** duhet te jene bashke me zarfin e logo te prodhuesit .
- **Furça per piktura**
- **Gersher zyre me doreza plastike** gersher duhet te jene me doreza plastike
- **Glue stik** Glue stik 21 gr
- **Gome per fshirje lapsi:** Gomë për laps, me përbërje prej gome të butë, pa përmbajtje PVC-je, e cila nuk shkakton irritim në lëkurë, nuk krijon papastërti gjatë përdorimit dhe nuk lë shenja në fletë. Përdoret për fshirjen e vijave të lapsit në skicime, vizatime apo shënime të ndryshme, pa dëmtuar sipërfaqen e letrës
- **Heqese telash kapsje:** Heqesja e kapseve është një vegël që duhet patur në zyrë apo shtëpinë tuaj. Ajo është e ndërtuar nga material i cilësisë së lartë dhe ka një dizajn mjaft elegant, heq shumë lehtë kaset metalike nga letrat pa I demtuar apo grisur ato.
- **Kanavec 60 cm x 4 cm Kanavac 1,6x10m.mod3** · Masa: 60 cm x40 cm · Materiali: Pambuk · Tipi: Pëlhurë e ashpër.
- **Kapse me veshe binder 25 mm dhe 32 mm:** Kapse aktesh me veshe metalik Masa: 25 mm; sasia 20 pako masa 31 mm 20 pako Materiali: Metal; Paketimi: 12.
- **Kapse me veshe binder mbi 32 mm:** Kapse aktesh me veshe metalik Masa: 41 mm; sasia 20 pako masa 51 mm 20 pako Materiali: Metal; Paketimi: 12; .
- **Karton format A4 me ngjyra te ndryshme.** Kartona format A4 me ngjyra te ndryshme ngjyra blu 50 cope , ngjyra e kuqe 300 ngjyra jeshile, ngjyra e verdhe 80 cope, ngjyra roze 200, ngjyra boj qelli 200 cope, ngjyr kafe 20 cope , ngjyra portokalli 50 cope, ngjyra vishnje 100 cope.

- **Karton me ngjyra (tabak) 70/100 200 gram** Ngjyra gri, ngjyra kuqe, ngjyra zeze, ngjyra bezhe, ngjyra kafe, ngjyra portokalli, ngjyra blu qiell, ngjyra blu, ngjyra e verdhe, ngjyra jeshile, ngjyra jeshile bari. ngjyra roze (50 per cdo ngjyre.)
- **Karton i bardhe (tabak) 70/100 200 gram** Ngjyra bardhe
- **Kopertina plastike.**
- **Korrektor:** Korrektor stilolaps i lëngshëm, prej materiali plastik rezistent, me kapak të tejdukshëm dhe me dizajn ergonomik, i cili e bën të lehtë dhe praktik në përdorim. Përdoret për korrigjimin e gabimeve të vogla drejtshkrimore, aplikohet me lehtësi në sipërfaqet e letrës dhe kartonit, thahet shpejt dhe lë një sipërfaqe të lëmuar.
- **Kuti per ruajtje te perhereshme :** KUTI ARKIVE PER RUAJTJE TE PERHERESHME 18X28X40 CM (PA NGJIT, VESHJE PL E BREND, ME VULE) ngjyra blu PCV.
- **Lapsa :** grafiti me gomë, me fortësi të vijës HB, prej materiali resini sintetik, me majë të përforcuar, që i reziston presionit të ushtruar nga dora e fëmijëve. Përdoren për të shkruar, skicuar apo për të mbajtur shënime të ndryshme, kanë strukturë ergonomike dhe janë praktikë në përdorim.
- **Lapustila** lapustilat me bazë uji , **lapustila** të qëndrueshëm ndaj ujit dhe pa aromë, me aftësi për tu tharë 30 copë ;ngjyra te ndryshme 40 cope
- **Letër A3:** Lëmueshmëria 80-100 ml/min, të mos jetë e ricikluar, e pakeluar me risma, të qëndrojnë e rrafshët dhe të mos lëshojë pluhur pas printimit ose fotokopjimi.
- **Letër A4:** Përmasa 297x210,Lëmueshmëria: 80-100 ml/min,Amballazhimi: Mbështjellje kundër,lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 risma.Përdorimi për fotokopje dhe printim.Lagështia:3.5-4.5%.Trashësia: 103-110 µm.Aftësia në përkulje: >110mN DM.Ashpërsia në përkulje: >54nm CD.Dukshmëria: >94%.Shkëlqimi: 101-104%.CIE bardhësia: 148-152.Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin.Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit.Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit.Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët.Të plotësojë standardet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë.  
Të mos jetë e ricikluar
- **Letër A4 me ngjyra :** Përmasa 297x210, Lëmueshmëria 80-100 ml/min ,160g jeshil,blu,verdhe.
- **Libër Protokolli:** Libër protokolli me 100 fletë. E përdorshme për bizneset të cilat mbajnë nr e protokolleve te dokumentave te ndryshem
- **Makinë Grirese Letre:** Nje pajisje e pershtatshme per zyra ,mund te futen 5 flete njekohesisht P4 (4x38mm).Kapaciteti mbajtes i koshit eshte 14 litra (rreth 60 flete A4), Shpejtesia 3000 mm / min. Niveli i zhurmese 72 dB, Permasat 180x370x321 mm.
- **Makinë kapëse letrash stapler 24/6:** Makinë për qepje dokumentesh, standardi 24/6, deri 25 fletë. Materiali plastik/metal. Të ketë dy mënyra të kapjes së letrës.

- **Makine kapse letre e madhe Stapler deri 240 flete** : Stepler për kapje fletësh, 23/6, 23/23 23/13 23/8. Mund të kapë deri në 240 fletë.
- **Makine Llogaritese e madhe**: Përmasat: 18x7x1.5 cm, Materiali: Plastik, Makine llogaritese. 10 digit. Makina ka 128 funksione te ndryshme.
- **Mandat arketimi me tre kopje**. Mandati I arketimit duhet te jete me 3 kopje.
- **Mbajtese** kancelarie Mbajtese e trefishtë metali, me pjesë të shkurtra dhe kompakte, të jete e fortë për dosjen e zyrës Materiali metalik me konstruksion kompakt, i ngurtë dhe i qëndrueshëm për artikujt e rëndë. Dizajni i rrjetës me pamje elegante . Sipërfaqja te jete e lyer me llak për mbrojtje nga ndryshku.Përmasat: Materiali: Metal Ngjyra: E zezë Madhësia e artikullit: 35 \* 29.5 \* 27.5cm / 13.8 \* 11.4 \* 10.6in
- Ngjiteses natriban i vogel **Natriban** i vogel 1.2 x 18 m\*40 Mic.
- Ngjiteses natriban I madhe. **Natriban** 4.8 cm x 60 m\* 50mic
- Ngjyra alkoli
- Ngjyra drur
- Penela me numra te ndryshem
- Plastelin
- **Qese plastike A4**: te jene me material te pllakes te tejdukshem, ne krahun e majte te jete me vrima per t'u vendosur ne dosje, te jene te amballazhuara dhe te pa hapura duhet te jene 300 mikrone, A4 me bira ,nje pako duhet te kete 100 copë.
- **Stilolaps** : Ky është një stilolaps cilësor MY-TECH 0.7mm, ka precizion të lartë gjatë shkrimit mbi çdo lloj letre. Boja cilësore e tij thahet shumë shpejt. Ai kryen një shkruajtje të butë, ka një majë sferike perfekte dhe është shumë rezistent.
- **Tela për makinë kapse mesatare 24/6-8**: Përshkrimi; telat te jenë të dizajnuara me material të cilësisë lartë dhe te ofrojnë një shpim të pastër nëpër fletët e shumta të letrës pa i dëmtuar ato duke siguruar një kapje të qëndrueshme. Kokat e telave në formë dalte kërkojnë më pak përpjekje për kapjen e letrave.Specifikimet: Cilësore, Përmasa: 23/8-13, Materiali: Metal, Paketimi: 1000 copë/kuti.
- **USB 8 GB**
- **Vinovil**: Ngjitës vinovil i lëngshëm. me përmbajtje aceto-vinili. pa përbërës të dëmshëm apo toksikë për lëkurën. në ngjyrë të bardhë. Përdoret për ngjitjen e objekteve prej materiali letre. kartoni dhe druri. dhe mund të pastrohet lehtësisht me ujë. Paketimi prej materiali plastik lejon aplikimin e ngjitësit edhe në sipërfaqe të vogla dhe nuk lejon që ngjitësi të thahet
- **Vizore te madhe 50 cm plastike** Vizore transparente me matje në 50 cm dhe sistemin britanik.
- **Vizore te vogla 30 cm plastike** Vizore transparente me matje në 30 cm dhe sistemin britanik.
- **Zarfa 11-23** Zarfi te jete ne permasat 11 me 23.



- **Zarfa A3.** Zarfa A3 DZ permasat 30x40 cm ngjyre e bardhe
- **Zarfa A4** Zarfa A4 permasat 23x33 cm ngjyre e bardhe 40 micron.

**Specifikimet teknike për kancelaritë.**

- Të jenë në përputhje me cilësimet e dhëna në preventiv.
- Të jenë origjinale dhe të cilësisë së parë.

➤ **Specifikimet teknike e tonerave për printerat dhe fotokopjet.**

- Tonerat/ Bojërat duhet të përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit.
- Tonerat duhet të jenë të reja, të papërdorura, të mbështjellë me qese, dhe të ambalazuara në kuti, të shoqëruara me pulla sigurie nga prodhuesi. Tonerat duhet të plotësojnë të gjithë elementet e sigurisë dhe do të kryhet kontroll rigoroz, për plotësimin e këtyre elementëve.
- Modeli i printerit dhe kodi i bojës duhet të jenë të printuara në kuti dhe në etiketa që ngjiten. Numri i serisë së kutisë duhet të korrespondojë me numrin e serisë së cartridge brenda në kuti.
- Tonerat për printer dhe fotokopje duhet të plotësojnë sasinë e faqeve sipas datasheet-in dhe katalogun përkatës të pajisjeve.
- Tonerat duhet të kenë datë skadence jo më pak se 1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës.
- Operatori ekonomik duhet të ofrojë garanci për mallin e ofruar, si dhe ndërrimin në rast difektsh fabrikimi.
- Ambalazhi i tonerave duhet të përmbajë markën, modelin, numrin serial, si dhe datën e skadencës e cila nuk duhet të jetë me pak se 1 vit nga data e dorëzimit të mallit

Përshkrimi I kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 6**

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit

**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

*Sasia e mallit që kërkohet:*

***Kancelari dhe tonera fotokopje dhe printerësh***

<b>Nr</b>	<b>TONERA FOTOKOPJE DHE PRINTERASH</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Cmimi</b>	<b>Vlera</b>
1	Brother DCP -1512E	cope	1		
2	Brother DCP-T520Ë	cope	2		
3	Brother HL-1118/DCP 1518/MFC-1813/1818	cope	1		
4	Brother MFC-L2752DË	cope	23		
5	Hp LaserJet P1005	cope	3		
6	Hp LaserJet P1018	cope	1		
7	HP Lazerjet 1022	cope	1		
8	Hp ProXpress M3820ND	cope	1		
9	Kyocera TASKalfa 2200	cope	1		
10	Kyocera FS-6525MFP	cope	10		
11	Lexmark E460dn	cope	2		
12	Lexmark 650	cope	1		
13	Lexmark E260D	cope	2		
14	Lexmark M5312dn	cope	3		
15	Lexmark Ms 310-610	cope	2		
16	Lexmark Ms 312dn	cope	1		
17	RICOH 305+	cope	5		
18	Ricoh Aficio MP171spf	cope	5		
19	Ricoh MP C3003 Black	cope	6		
20	Ricoh MP C3003 Ngjyra (CYAN.MAG.YELL)	cope	5		
21	RICOH SP 330SN	cope	1		
22	Samsung ML 5510ND	cope	1		
23	Xerox Phaser 3124	cope	1		
24	Xerox 3025	cope	1		
25	XEROX Phaser 31-34	cope	2		
26	Xerox VersaLink B7030	cope	1		
27	Xerox NL-5928 RC	cope	1		
<b>SHUMA BOJE PRINTERI</b>					
<b>MATERIALE KANCELARIKE</b>					
1	Bloqe Flete Dalje (3 kopje)	cope	130		
2	Blok me ngjitje stick notes	pako	100		

3	<i>Blllok Urdher Dorezimi (3 kopje)</i>	<i>cope</i>	70		
4	<i>Blloqe shenimesh</i>	<i>Cope</i>	50		
5	<i>Boje vule</i>	<i>cope</i>	10		
6	<i>Bojra akrilike</i>	<i>komplete</i>	40		
7	<i>Bojra esencenciale ngjyra te ndryshme</i>	<i>pako</i>	40		
8	<i>Bojra Uji</i>	<i>komplete</i>	40		
9	<i>Bojra Vaji</i>	<i>komplete</i>	10		
10	<i>Dosje me llastik 5 cm</i>	<i>cope</i>	100		
11	<i>Dosje me llastik me ngyre</i>	<i>cope</i>	1000		
12	<i>Dosje me mekanizem</i>	<i>cope</i>	50		
13	<i>Dosje personeli me logon e bashkise bulqize</i>	<i>cope</i>	100		
14	<i>Dosje te thjeshta kartoni</i>	<i>cope</i>	1000		
15	<i>DVD+RĚ 4X 4.7GB, CD-R 52X700MB</i>	<i>cope</i>	10		
16	<i>Furça per pikturë</i>	<i>cope</i>	40		
17	<i>Gershere zyre me doreza plastike</i>	<i>cope</i>	5		
18	<i>Glue stik</i>	<i>cope</i>	100		
19	<i>Goma per fshirje</i>	<i>cope</i>	100		
20	<i>Hapse telash kapsje</i>	<i>cope</i>	30		
21	<i>Kanavace 60cm x 40cm</i>	<i>cope</i>	40		
22	<i>Kapse aktesh me vesh binder 25 mm dhe 32 mmm</i>	<i>pako</i>	50		
23	<i>Kapse aktesh me vesh binder mbi 32 mmm</i>	<i>pako</i>	40		
24	<i>Karton format A 4 me ngjyra te ndryshme</i>	<i>cope</i>	1000		
25	<i>Kartona me ngjyra (tabak) 50x70</i>	<i>flete</i>	600		
26	<i>Kartona te bardhe Tabak 50x70</i>	<i>flete</i>	600		
27	<i>Kopertina transparente plastike</i>	<i>cope</i>	200		
28	<i>Korektor</i>	<i>cope</i>	100		
29	<i>Kuti per ruajtje te perhershme</i>	<i>cope</i>	30		
30	<i>lapsa plumbi</i>	<i>cope</i>	100		
31	<i>Lapustila</i>	<i>pako</i>	70		
32	<i>Leter A3</i>	<i>risma</i>	30		
33	<i>Leter A4</i>	<i>Risma</i>	1203		
34	<i>Leter A4 ngjyra te ndryshme</i>	<i>Risma</i>	20		
35	<i>Liber protokolli</i>	<i>cope</i>	20		
36	<b>Makinë Grirese Letre:</b>	<i>cope</i>	1		
37	<i>Makine kapse letrash Stapler24/6</i>	<i>cope</i>	50		

38	Makine kapse letre e madhe Stapler deri 240 flete	cope	2		
39	Makine llog e madhe	cope	10		
40	Mandat arketimi me tre kopje	cope	200		
41	Mbajtese kancelarish me 3 kate	cope	10		
42	Ngjites natriban I vogel	cope	60		
43	Ngjites natriban I madh	cope	40		
44	Ngjyra alkoli	pako	50		
45	Ngjyra druri	pako	50		
46	penela me numra te ndryshem	pako	40		
47	Plasteline	cope	100		
48	Qese plastike A4	pako	100		
49	Stilolapsa te mire cilesor	cope	1200		
50	Tela për makinë kapse mesatare 24/6-8	pako	80		
51	Usb 8 GB	cope	20		
52	Vinovil	cope	100		
53	Vizore te medha 50 cm plastike	cope	30		
54	Vizore te vogla 30 cm plastike	cope	30		
55	Zarfa 11-23	cope	2000		
56	Zarfa A3	cope	300		
57	Zarfe A4	cope	500		

*Afatet e lëvrimit:*Sipas kërkesave dhe nevojave të AK brenda afatit 20 ditor.

III1.2. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 111, “Paraqitja e ankesës”, 1.Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e

ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik". Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij, se kërkesat e autoritetit kontraktor nuk janë të logjikshme, ankimuesi duhet të kishte shoqëruar pretendimet e tij me prova, indicie dhe argumente, në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga autoriteti kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e autoritetit kontraktor dhe të hartojë e argumentojë të gjitha kërkesat e procedurës së prokurimit në themel. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për këto specifikime në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, pesha specifike e barrës për të provuar shkeljen e konstatuar qëndron mbi pretenduesin, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plota provuese, se cilat kritere/specifikime teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë të paqarta dhe konfuze.

Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjitha apo shumicën e elementeve përbërëse të dokumenteve të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si i tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik, i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim.

III.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Interlogistic" SHPK, se [...]Sa me siper, percaktimi nga autoriteti kontraktor i specifikimeve per artikullin toner, kritere te percaktuara per te gjitha llojet e tonerave te kerkuara nga ana Juai, na detyron qe te kerkojme qe "" keto specifikime te ndryshohen/modifikohen duke shtuar fialën ekuivalent, kjo e sanksionuar ne njoftimin e Agjencise se Prokurimit Publik nr. 8297/3 prot datë 23.01.2020 me lende

\* Njoftim "Sipas ketij njoftimi do autoritet kontraktore qe kerkon tonera original duhet te perfshije edhe fjalen ekuivalent gje te cilen institucioni Juaj nuk e ka perfshire Kërkesa Juaj per tonera original pa perfshire termin ose ekuivalente con vetem tek prodhuesit e pajisjeve, per te cilat kerkohen tonera, duke shmangur prodhues te tjere qe ofertojne tonera ekuivalent me

originalitet, veprim i cili sjell si pasoje kufizimin e pjesmarrjes se operatorëve ekonomike.[..]  
Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2 Në shtojcën 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të Lëvrimit” ne DST, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

**Shtojca 6**

1. (Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)
2. (Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)
3. **FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

**Kancelari dhe tonera fotokopje dhe printerash**

<b>Nr</b>	<b>TONERA FOTOKOPJE DHE PRINTERASH</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Cmimi</b>	<b>Vlera</b>
1	Brother DCP -1512E	cope	1		
2	Brother DCP-T520Ë	cope	2		
3	Brother HL-1118/DCP 1518/MFC-1813/1818	cope	1		
4	Brother MFC-L2752DË	cope	23		
5	Hp LaserJet P1005	cope	3		
6	Hp LaserJet P1018	cope	1		
7	HP Lazerjet 1022	cope	1		
8	Hp ProXpress M3820ND	cope	1		
9	Kyocera TASKalfa 2200	cope	1		
10	Kyocera FS-6525MFP	cope	10		
11	Lexmark E460dn	cope	2		
12	Lexmark 650	cope	1		
13	Lexmark E260D	cope	2		
14	Lexmark M5312dn	cope	3		
15	Lexmark Ms 310-610	cope	2		
16	Lexmark Ms 312dn	cope	1		
17	RICOH 305+	cope	5		
18	Ricoh Aficio MP171spf	cope	5		
19	Ricoh MP C3003 Black	cope	6		
20	Ricoh MP C3003 Ngjyra (CYAN.MAG.YELL)	cope	5		
21	RICOH SP 330SN	cope	1		
22	Samsung ML 5510ND	cope	1		
23	Xerox Phaser 3124	cope	1		

24	Xerox 3025	cope	1		
25	XEROX Phaser 31-34	cope	2		
26	Xerox VersaLink B7030	cope	1		
27	Xerox NL-5928 RC	cope	1		
<b>SHUMA BOJE PRINTERI</b>					
<b>MATERIALE KANCELARIKE</b>					
1	Blloqe Flete Dalje (3 kopje)	cope	130		
2	Blok me ngjitje stick notes	pako	100		
3	Blok Urdher Dorezimi (3 kopje)	cope	70		
4	Blloqe shenimesh	Cope	50		
5	Boje vule	cope	10		
6	Bojra akrilike	komplete	40		
7	Bojra esencenciale ngjyra te ndryshme	pako	40		
8	Bojra Uji	komplete	40		
9	Bojra Vaji	komplete	10		
10	Dosje me llastik 5 cm	cope	100		
11	Dosje me llastik me ngjyre	cope	1000		
12	Dosje me mekanizem	cope	50		
13	Dosje personeli me logon e bashkise bulqize	cope	100		
14	Dosje te thjeshta kartoni	cope	1000		
15	DVD+RË 4X 4.7GB, CD-R 52X700MB	cope	10		
16	Furça per pikturë	cope	40		
17	Gershere zyre me doreza plastike	cope	5		
18	Glue stik	cope	100		
19	Goma per fshirje	cope	100		
20	Hapse telash kapsje	cope	30		
21	Kanavace 60cm x 40cm	cope	40		
22	Kapse aktesh me vesh binder 25 mm dhe 32 mmm	pako	50		
23	Kapse aktesh me vesh binder mbi 32 mmm	pako	40		
24	Karton format A 4 me ngjyra te ndryshme	cope	1000		
25	Kartona me ngjyra (tabak) 50x70	flete	600		
26	Kartona te bardhe Tabak 50x70	flete	600		
27	Kopertina transparente plastike	cope	200		
28	Korektor	cope	100		
29	Kuti per ruajtje te perhershme	cope	30		

30	<i>lapsa plumbi</i>	<i>cope</i>	100		
31	<i>Lapustila</i>	<i>pako</i>	70		
32	<i>Leter A3</i>	<i>risma</i>	30		
33	<i>Leter A4</i>	<i>Risma</i>	1203		
34	<i>Leter A4 ngjyra te ndryshme</i>	<i>Risma</i>	20		
35	<i>Liber protokolli</i>	<i>cope</i>	20		
36	<b>Makinë Grirese Letre:</b>	<i>cope</i>	1		
37	<i>Makine kapse letrash Stapler24/6</i>	<i>cope</i>	50		
38	<i>Makine kapse letre e madhe Stapler deri 240 flete</i>	<i>cope</i>	2		
39	<i>Makine llog e madhe</i>	<i>cope</i>	10		
40	<i>Mandat arketimi me tre kopje</i>	<i>cope</i>	200		
41	<i>Mbajtese kancelarish me 3 kate</i>	<i>cope</i>	10		
42	<i>Ngjites natriban I vogel</i>	<i>cope</i>	60		
43	<i>Ngjites natriban I madh</i>	<i>cope</i>	40		
44	<i>Ngjyra alkoli</i>	<i>pako</i>	50		
45	<i>Ngjyra druri</i>	<i>pako</i>	50		
46	<i>penela me numra te ndryshem</i>	<i>pako</i>	40		
47	<i>Plasteline</i>	<i>cope</i>	100		
48	<i>Qese plastike A4</i>	<i>pako</i>	100		
49	<i>Stilolapsa te mire cilesor</i>	<i>cope</i>	1200		
50	<i>Tela për makinë kapse mesatare 24/6-8</i>	<i>pako</i>	80		
51	<i>Usb 8 GB</i>	<i>cope</i>	20		
52	<i>Vinovil</i>	<i>cope</i>	100		
53	<i>Vizore te medha 50 cm plastike</i>	<i>cope</i>	30		
54	<i>Vizore te vogla 30 cm plastike</i>	<i>cope</i>	30		
55	<i>Zarfa 11-23</i>	<i>cope</i>	2000		
56	<i>Zarfa A3</i>	<i>cope</i>	300		
57	<i>Zarfe A4</i>	<i>cope</i>	500		

**Afatet e lëvrimit:** Sipas kërkesave dhe nevojave të AK brenda afatit 20 ditor.

III.2.2 Autoriteti Kontrkaor me shkresen nr 4568/1 date 14.09.2023 protokolluar me tonën 1991/3 datë 18.09.2023 ka cituar, se “ Per sa kerkoni ne tuajen per ankesen e bere nga operatori ekonomik "Interlogistic" SHPK., Prane Autoritetit Kontraktor Bashkia Bulqize nuk eshte



*paraqitur anje ankese nga operatori ekonomik "Interlogistic" SHPK, per modifikim te dokumenteve te tenderit per proceduren e prokurimit me nr. REF -77043-08-08-2023 me objekt "Kancelari dhe Tonerat Fotokopje dhe Printerash" me fond limit 1 333 333. 33 leke pa TVSh parashikuar per t'u zhvilluar ne date 21.08.2023"*

III.2.3 Referuar Nenit 36 pika 3, "Specifikimet teknike" të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik",

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

*b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

*c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

*ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

III.2.4. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve ofertues, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të

përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.

Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionalë sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj” në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

KPP gjykon se, ofrimi i pjesëve të konsumueshme, siç janë edhe tonerat, duhet të jenë cilësorë të sigurojnë mirëfunksionimin e pajisjeve dhe cilësinë e printimeve. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se vendosja e specifikimeve teknike fikse që nuk janë në përpjesëtim me natyrën dhe objektin e procedurave të prokurimit publik është kufizuese dhe çon drejt një prodhuesit të vetëm. Përcaktimi i këtyre specifikimeve nga autoriteti kontraktor duhet t’i shërbejë autoritetit kontraktor, por njëkohësisht duhet të vlerësohet sipas një diapazoni të arsyeshëm dhe proporcional për realizimin e kontratës, me qëllim hapjen e konkurrencës.

Pretendimi i operatorit ekonomik për shtimin e termit “ekuivalent” për tonerat, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet t’i përmbahet parashikimeve të ligjit mbi përdorimin e termit “*Ekuivalente*” që do të nënkuptojë - *malli ose shërbimi i ofruar me karakteristika të barasvlefshme me ato që janë përcaktuar në specifikimin teknik.*

Në këtë kuptim KPP gjykon, se kërkesa e OE për [...shtimin e fjalës “ose ekuivalent”...] është në përputhje me përcaktimet ligjore. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 36 pika 3, “*Specifikimet teknike*” të ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*” gjykon, se kërkesat e vendosura nga ana e AK-së për tonerat, duhet të modifikohen duke përdorur termin “*ose ekuivalentë*”,

Kërkesa e operatorit ekonomik për ndryshime të kërkesës për tonerat, qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Interlogistic ” SHPK

*Per sa i perket artikullit nr. 2 "Bllok me ngjitje stick notes" kerkojme nga ana e Grupit te Shqyrtimit te Ankeses/Komisionit te Prokurimit Publik qe per kete artikull qe te specifikohen dimensionet e artikullit si dhe njesia, pako me sa flete.*

*Per artikullin nr. 4 "Blloqe shenimesh" kerkojme nga ana e Grupit te Shqyrtimit te Ankeses/Komisionit te Prokurimit Publik qe per kete artikull qe te specifikoni dimensionet dhe numrin e faqeve.*

*Per artikullin nr. 6 "Bojra akrilike", nr. 7 "Bojra esencenciale ngjyra te ndryshme" ", nr. 8 "Bojra Uji", 9 "Bojra Vaji", nr. 44 "Ngjyra alkoli". nr. 45 "Ngjyra druri", dhe nr. 46 "panela me numra te ndryshem" kerkojme nga grupi i Shqyrtimit te Ankesave/Komisinit te Prokurimit Publik qe te specifikoni numrin e bojrave qe kerkohet ne pako.*

*Ne lidhje me artikullin nr. 18 "Glue stik" kerkojme nga ana e Grupit te Shqyrtimit te Ankeses/Komisionit te Prokurimit Publik qe per kete artikull te percaktoni peshen ne gram te ketij artikulli.*

*Në lidhje me artikullin nr. 20 "Hapse telash kapsje" kerkojme nga ana e Grupit të Shqyrtimit te Ankeses/Komisionit te Prokurimit Publik qe per kete artikull te konfirmoni nëse ju duhet heqese telash.*

*Në lidhje me artikullin nr. 22 "Kapse aktesh me vesh binder 25 mm dhe 32 mmm" kerkojme nga ana e Grupit te Shqyrtimit te Ankeses/Komisionit te Prokurimit Publik qe percaktoni ne menyre te sakte se cilin nga artikujt kerkohet, Kapse aktesh me vesh binder 25 mm apo 32 mm pasi ne lidhje me keto dy artikuj kemi vlera te ndryshme. Gjithashtu, lutemi te konfirmoni pakon standarde me 12 cope.*

*Per artikullin nr. 23 "Kapse aktesh me vesh binder mbi 32 mmm" kerkojme nga ana e Grupit te Shqyrtimit te Ankeses/Komisionit te Prokurimit Publik qe te konfirmoni pakon standarde me 12 cope.*

*Per artikullin nr. 31 "Lapustila" kerkojme nga ana e Grupit te Shqyrtimit te Ankeses/Komisionit te Prokurimit Publik qe te specifikoni numrin e bojrave qe permban pako.*

*Ndersa per artikullin nr. 36 "Makine Grirese Letre:" kerkojme nga ana e Grupit të Shqyrtimit te Ankeses/Komisionit te Prokurimit Publik qe te specifikoni per sa flete duhet makina grirëse. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi para kërkimit për sqarime mbi specifikimet teknike të artikujve të procedurës së prokurimit. Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikim ligjor apo specifikim teknik në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik), por në thelb janë paqartësi mbi specifikimet teknike të artikujve të sipërcituara. Gjithashtu, KPP-ja konstaton, se autoriteti kontraktor, nuk ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues, siç duhet në përputhje me nenin 75 të LPP-së i cili parashikon shprehimisht se: "Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3*

ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.” Ndaj, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të sqarojë operatorin ekonomik ankimues në mënyrë të argumentuar dhe shteruese lidhur me paqartësitë e parashtruara në ankesë. Gjithashtu, Komisioni sjell në vëmendje, se këto sqarime duhet të publikohen në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

#### III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK

*Për artikullin nr. 51 "Usb 8 GB" kerkojme nga ana e Grupit te Shqyrtimit te Ankesës/Komisionit te Prokurimit Publik qe te ndryshojne specifikimin teknik "USB 8 GB" duke qene se ky specifikim është jashte prodhimit, specifikimet standarde jane 16 GB de 32 GB.*

##### III.4.1 Ne shtojcën 6, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

51	Usb 8 GB	cope	20		
----	----------	------	----	--	--

##### III.4.2. Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

*“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*

*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.*

*Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.*

*Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."

III 4.3 Nga shqyrtimi i specifikimeve teknike Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se autoriteti kontraktor gjatë hartimit të specifikimeve teknike, ka përshkruar në mënyrë tepër të detajuar produktet që kërkon të blejë me anë të kësaj procedure prokurimi. Komisioni vëren, se në shumicën e rasteve, specifikimet teknike janë hartuar me përcaktime fikse, kërkesa fikse, duke kufizuar ndjeshëm konkurrencën, si dhe duke privuar nga e drejta e ofertimit operatorë

ekonomikë të interesuar, të cilët mund të ofrojnë produkte me kapacitete edhe më të mira. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publike është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit, duke përfshirë edhe hartimin e specifikimeve teknike. Përcaktimi në mënyrë të detajuar i specifikave që nuk ndikojnë në funksionalitetin apo nuk vërtetojnë cilësinë e artikujve objekt-prokurimi, si dhe përcaktimi i parametrave fikse, duke i kufizuar në mënyrë eksplicite ato, kufizon pjesëmarrjen në këtë procedurë prokurimi e për pasojë kufizon konkurrencën. Gjithashtu, konstatohet, se janë përcaktuar specifikime teknike që nuk ndikojnë aspak në funksionalitetin e artikujve.

III.4.4 Me konkretisht, në rastet e artikullit të sipërpërmendur me nr. rendor 51 USB 8GB, autoriteti kontraktor ka përcaktuar parametra fikse, dhe ky specifikim teknik nuk ndikon aspak në funksionalitetin apo performancën e artikullit të mësipërm, duke kufizuar ndjeshëm konkurrencën. Referuar specifikimeve teknike, Komisioni gjykon, se për artikujt që do të prokurohen, specifikimet teknike mund të hartohen më lehtësisht për ofertimin nga ana e operatorëve ekonomikë. Për këtë arsye, specifikimi teknik lidhur me këte të fundit, duhet të modifikohet, duke caktuar diapazon të pranueshëm me qëllim hapjen e konkurrencës. Përcaktime fikse të tilla, kufizojnë në mënyrë të panevojshme konkurrencën, pasi përjashton ata operatorë ekonomikë që ofertojnë artikujt e mësipërm me parametrat dhe cilësitë funksionale të kërkuara. Për këtë arsye, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike, duke vendosur diapazon të arsyeshëm për parametrat funksionalë të tyre, me qëllim hapjen e konkurrencës.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK për procedurën e prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*” me Nr. REF-77043-08-08-2023, me objekt “*Kancelari dhe Tонера fotokopje dhe printerash*”, me fond limit 1,333,333.33 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 21-08-2023, nga autoriteti kontraktor Bashkia Bulqizë.
  2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
  4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**